



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
KRYETARI

Nr. 509/11, Prot.

Tiranë, më 30/09/2017

V E N D I M

Nr. 137, Datë 30/09/2017

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR
NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME, “MBI PËRPUTHSHMËRINË DHE
RREGULLSHMËRINË FINANCIARE”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.1 54/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, të ushtruar në Ministrinë e Punëve të Jashtme sipas programit të auditimit nr. 509/1, dt. 19.05.2017 për veprimtarinë nga data 01.01.2015 deri 30.04.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Detyrimi i (llog. 468) “*Debitorë të ndryshëm*” në fund të vitit 2016 rezulton në vlerën 489,528 lekë i cili paraqet detyrimet e subjekteve private dhe punonjësve ndaj institucionit. Pra i zbërthyer në mënyrë analitike përbëhet nga detyrimet e 10 subjekteve të cilat nuk kanë derdhur asnjë vlerë nga detyrimi për një periudhë 5 vjeçare.

1.1 Rekomandoj:

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të kërkohej dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i debitorëve, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme administrative, deri në arkëtimin e vlerës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015 nga MPJ janë lidhur kontrata punimesh, shërbimi, mallrash të cilat përfundonin gjatë këtij viti (10 kontrata) në vlerën 177,359,746 lekë. Për vitin 2016 nga MPJ janë lidhur kontrata punimesh, shërbimi, mallrash të cilat përfundonin gjatë këtij viti (12 kontrata) në vlerën 323,059,530 lekë. Gjatë viteve respektive një pjesë e tyre janë likuiduar në periudha të ndryshme në vlera pjesore. Vlerat e mbetura pa u likuiduar nga vlera e kontratave nuk është kontabilizuar si angazhim. Vlerat pjesore të likuiduar me urdhër shpenzimet përkatëse janë kontabilizuar dhe janë paraqitur si detyrim dhe në të njëjtën kohë edhe si likuidim i këtij detyrimeve në llogarinë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”.

2.1 Rekomandoj:

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sektori i Financës të merren masat për të pasqyruar këtë vlerë në pasqyrat financiare bazuar në standardet e kontabilitetit publik për të mundësuar një pamje të drejtë të nevojave për fonde në përfitim të këtyre kontratave.

Të bashkëpunohet me Ministrinë e Financave për një trajtim në përputhje me IPSAS dhe rritje të cilësisë së raportimit financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016 ka dalë urdhri nr. 9, datë 05.01.2017 “*Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve*” i Sekretarit të Përgjithshëm G.B. sipas referencës ligjore, ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi.

Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitin 2016 nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e MPJ-së, për vitin 2016, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

3.1 Rekomandoj:

Nga Komisionet e Inventarizimit të hartohet një raport mbi procesin e inventarizimit të aktiveve, kushtet e ruajtjes, gjendjen fizike, diferencat e konstatuara dhe personat përgjegjës.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në kuadër të zbatimit të projektit të miratuar “*Përforcimi i kapaciteteve të diplomacisë publike dhe ekonomike të Ministrisë së Punëve të jashtme*” një bashkëpunim i Qendrës së Ekselencës me Ambasadën Zvicerane nga Ministria janë kontraktuar konsulentë të jashtëm për hartimin e artikujve analitikë e studimorë në vlerën e 5,904,100 lekë. Me Urdhër Shpenzimet janë likuiduar sipas subjekteve përfitues vlera për konsulencë dhe artikuj studimore për vitet 2015 dhe 2016 në vlerën **5,018,485** lekë duke mbajtur tatimin në burim.

-Vlera e studimeve e likuiduar ka kaluar në shpenzime por nuk është paraqitur në aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara.

- Në urdhër shpenzimet është likuiduar vlera neto duke u mbajtur tatimi në burim por nuk është pasqyruar në kontabilitet si detyrim për tu paguar ndaj administratës tatimore e parashikuar edhe në kontratat përkatëse në momentin e likuidimit të vlerës por me Urdhër Pagesa të veçantë sipas një përmbledhje të vlerave të mbajtura.

- Vlera e likuiduar për tatimin në burim është kontabilizuar në llogarinë 467 “Kreditorë të tjerë” kur duhej që për çdo urdhër shpenzimi vlera e llogaritur për tatimin në burim duhej të kontabilizohet në llogarinë 4311 “Të drejta e taksa për tatime, të vitit në vazhdim”.

4.1 Rekomandoj:

- Nga MEPJ sektori i financës të merren masat për kontabilizimin e vlerave të likuiduara të studimeve duke i paraqitur në aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara dhe njëkohësisht inventarizimi i tyre.

- Nga Sektori i Financës të merren masat që, në të njëjtën kohë kur kryhet pagesa me urdhër shpenzimet, tatimi në burim i mbajtur të pasqyrohet në kontabilitet si detyrim për tu paguar ndaj administratës tatimore e parashikuar në llogarinë 4311 “Të drejta e taksa për tatime, të vitit në vazhdim” në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimin i zbatimit të procedurave të blerjes së automjeteve për Përfaqësitë Shqiptare jashtë shtetit u konstatua:

A. Me Urdhër shpenzimin nr. 139, dt. 21.10.2014 është transferuar fondi për llogari të ambasadave në vlerën 21,158,635 lekë. Ky fond është transferuar për ambasadat e mëposhtme në vlerën 150,000 EURO;

Ambasada Paris për 30,000 EURO, Ambasada Berlin për 30,000 EURO, Ambasada Lubjana për 30,000 EURO, Ambasada Zagreb për 30,000 EURO, Ambasada Prishtinë për 30,000 EURO.

Ambasadat e mësipërme, kanë dërguar në Drejtorinë e Programit Buxhetor dhe të Financës, proces verbalet e mbajtura nga komisionet për përzgjedhjen e ofertave për blerjen e automjetit protokollar të ambasadës ku bashkëngjitur janë tre ofertat e marra nga komisionet dhe ajo fituese.

Me shkresat përkatëse Sekretari i përgjithshëm z. Q.Q. i është drejtuar Ministrit për miratimin e ofertave fituese të propozuar nga Drejtoria e Programimit Buxhetor dhe Financës, të miratuara nga Ministri.

Nga verifikimi i inventarëve të dërguara nga Ambasadat e mësipërme me shkresat përkatëse rezultoi se në inventarin e automjeteve në administrim të përfaqësive krahas automjeteve të tjera rezultojnë edhe automjetet e blera nga përfaqësitë gjatë vitin 2014 sipas ofertave fituese.

U konstatua:

1. Nga Ambasada Paris fondi limit i miratuar dhe Oferta fituese e miratuar është 31,548 Euro kurse vlera e blerjes sipas inventarit të mësipërm është 32,329.64 Euro. Vlera e ofertës është tejkaluar me **781.64** Euro.

2. Nga Ambasada Lubjanë mungon proces verbali i mbajtur nga komisioni për përzgjedhjen e ofertave për blerjen e automjetit protokollar të ambasadës. Bashkëngjitur është vetëm një ofertë.

3. Nga Ambasada Zagreb mungon proces verbali i mbajtur nga komisioni për përzgjedhjen e ofertave për blerjen e automjetit protokollar të ambasadës.

4. Nga Ambasada Prishtinë mungon proces verbali i mbajtur nga komisioni për përzgjedhjen e ofertave për blerjen e automjetit protokollar të ambasadës.

5. Procedura e blerjes së këtyre automjeteve nuk është kryer e përqendruar nga Ministria e Punëve Brendshme në kundërshtim me VKM nr. 53, dt. 21.01.2009 “Për ngarkimin e ministrisë së brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë për disa mallra e shërbime” i ndryshuar (shfuqizuar me VKM nr. 28, dt. 14.01.2015) pika 1. Ngarkohet e Ministria e

Brendshme, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të kryeministrit e të ministrive të linjës, për blerjen e mallrave dhe shërbimeve si..... Blerje automjetesh, etj...

B. Me Urdhër shpenzimit nr. 180, dt. 31.12.2014 është transferuar fondi për llogari të ambasadave në vlerën 30,000,000 lekë. Ky fond është transferuar për ambasadat e mëposhtme në vlerën 211,348 EURO;

Misioni NATO-s Bruksel për 150,000 EURO. Misioni i BE-së Bruksel për 61,348 EURO.

Bashkëngjitur urdhër shpenzimit janë urdhri i transferimit i datës 31.12.2014 i firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm z. Q.Q. me vlerat përkatëse në euro për secilën nga përfaqësitë e mësipërme. Ky fond është transferuar në llog. e misioneve të mësipërme me arsyetimin për të mos u djegur në fund të vitit 2016.

- Memorandumi për vendimmarrje nr. 48/1, dt. 25.02.2015 nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm z. Q.Q. i është drejtuar Ministrit ku i kërkohet miratimi për procedurën që duhet të ndiqet për prokurimin e automjeteve për përfaqësitë ku argumentohet se zhvillimi i procedurave të prokurimit nga vetë përfaqësitë ka hasur në vështirësi në realizimin e tyre, si pasojë e mungesës së personelit dhe kualifikimit të tyre në fushën e prokurimeve publike. Për rrjedhojë MPJ duhet të vlerësojë përcaktimin e procedurës së prokurimit, bazuar në gjendjen faktike të personelit në dispozicion të çdo përfaqësie për të cilën është dhënë miratimi si dhe për procedurat që do të ndiqen në vlerësimin e ofertave..... Në lidhje me procedurën e vlerësimit sugjerohet që KVO e miratuar nga ministri me nr. 59, dt. 04.03.2015 mbasi të grumbullojë ofertat e përcjella nga përfaqësitë duhet të vlerësojë ofertën në bazë të rregullave të prokurimit publik bazuar në ofertën me çmimin më të ulët. Ky memorandum është miratuar edhe nga Ministri.

- Me memorandum për vendimmarrje të datës 19.03.2015 e KVO është miratuar nga ministri sugjerimi për ofertat e përzgjedhur nga KVO dhe janë miratuar blerja e artikullit automjete për pajisjen me autoveturë protokollare të përfaqësive; Stokholm, Varshavë, Bari, Pragë, Misioni i BE, Bukuresht dhe Sofje.

- me shkresën nr. 6845, dt. 15.04.2015 drejtuar konsullatës së përgjithshme të Shqipërisë në Bari nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse është dërguar udhëzimi që në zbatim të urdhrit të firmosni kontratën për blerjen e automjeteve me koncesionarin Mercedes Benz në Bari, me ofertën **32,400** Euro.

- Nga verifikimi i inventarëve dhe kontratave të dërguara nga përfaqësitë rezultoi se në inventarin e automjeteve në administrim të përfaqësive krahas automjeteve të tjera rezultojnë automjete e blera për vitin 2015.

U konstatua:

- Likuidimi i vlerës së blerjes së automjeteve është kryer nga përfaqësitë nga llogaria e tyre e çelur sipas transfertave nga llog. 600, 601, 602, 605 dhe jo nga llog. 231 për të cilën gjatë vitit 2015 nuk ka çelje përkatësish për përfaqësitë që kanë kryer likuidimin e vlerave për automjetet e blera si: Stokholm, Varshavë, Bari, Pragë, Misioni i BE, Bukuresht.

- Nga verifikimi i inventarëve dhe kontratave të dërguara nga përfaqësitë rezultoi se në inventarin e automjeteve në administrim të përfaqësive krahas automjeteve të tjera rezultojnë automjete e blera për vitin 2015 me ndryshimin në:

1. Ambasada **Stokholm** ka blerë “Mercedes Benz E 200 BlueTEC SEDAN”, viti 2015, me nr. shasie WDD2120061B227993 me vlerën e inventarit 25,523 Euro. (sipas inventarit të dërguar me shkresën nr. 120, dt. 18.07.2017) Ky automjet është blerë nga vetë ambasada e Stokholmit dhe jo sipas ofertës fituese me koncesionarin “Mercedes Benz” Motoria srl Bari prej 32,400 Euro.

2. Përfaqësia **Bari** ka blerë dy automjete:

- “Mercedes Benz, W205 Classe C – Limousine C 200 BlueTEC Automatic C”, viti 2015, me nr. shasie WDD2050371R075245 me vlerën e inventarit 32,400 Euro, me targa CC0029AA.

Kontrata dt. 30.04.2015 me koncensionarin "Mercedes Benz" Motoria srl firmosur nga përfaqësuesi Konsullatës Bari, modeli "Mercedes Benz, Classe E Berlina E 200 Blue TEC".

- "Mercedes Benz, Classe E Berlina E 200 Blue TEC" viti 2015 me nr. shasje WDD2120061B234966 me vlerën e inventarit 32,400 Euro, me targa CC0030AA. Kontrata dt. 30.04.2015 me koncensionarin "Mercedes Benz" Motoria srl firmosur nga përfaqësuesi Konsullatës Bari, modeli "Mercedes Benz, W205 Classe C – Limousine C 200 BlueTEC Automatic". *Si shikohet edhe nga kontrata e mësipërme blerja për modelin "Mercedes Benz, W205 Classe C – Limousine C 200 BlueTEC Automatic", nuk është në përputhje me specifikimet e ofertës fituese dhe urdhërit e Sekretarit të përgjithshëm nr. 92, dt. 14.04.2015. Kontrata me koncensionarin duhej të lidhej për modeli "Mercedes Benz, Classe E Berlina E 200 Blue TEC".*

- Në memorandumun e datës 19.03.2015 e miratuar nga Ministri rezulton se në përfaqësitë që do të pajisen me automjete figuron edhe përfaqësia e Shqipërisë në Sofje, e cila nuk rezulton të jetë pajisur.

- Me miratimin e memorandumit të mësipërm nga MPJ janë marrë të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore për të kryer vetë procedurat e prokurimeve. Gjithashtu nuk u paraqit ndonjë dokument ku të jenë përcaktuar rregullat që do të ndiqen nga përfaqësitë për procedurat e blerjes së automjeteve. Sa më lart është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 28, dt. 14.01.2015, i ndryshuar, nën pika 1.3 "Përjashtimisht, lejohen përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, që procedurat për blerje automjeteve ti realizojë vetë, sipas rregullave të tyre të brendshme".

5.1 Rekomandoj:

- Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ambasada Paris të merren masat për arkëtimin e vlerës prej 781,64 Euro si diferencë midis fondit limit të miratuar, Oferta fituese 31,548 Euro dhe vlerës së blerjes sipas inventarit prej 32,329.64 Euro.

- Të merren masat për plotësimin e dosjeve pranë Ministrisë me dokumentacionin përkatës për blerjet e automjeteve nga përfaqësitë jashtë shtetit për vlerat sipas Urdhër Shpenzimit nr. 139, dt. 21.10.2014.

- Nga Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financë të merren masat që likuidimet nga Përfaqësitë jashtë shtetit për shpenzimet e tyre të kryhen nga llogaritë përkatëse të çelura sipas transfertave dhe natyrës së shpenzimit buxhetore.

- Me miratimin e memorandumit për kryerjen nga MEPJ e procedurave të blerjes së automjeteve janë marrë të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore për të kryer vetë procedurat e prokurimeve sipas VKM nr. 28, dt. 14.01.2015.

- Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Përfaqësitë Diplommatike të merren masat për të përcaktuar rregullat që do të ndiqen nga përfaqësitë për procedurat e blerjes së automjeteve. Sipas përcaktimit të VKM nr. 28, dt. 14.01.2015, i ndryshuar, nën pika 1.3 "Përjashtimisht, lejohen përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, që procedurat për blerje automjeteve ti realizojë vetë, sipas rregullave të tyre të brendshme".

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës sipas deklaratës doganore SAD ose datës sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si "taksa e markimit".

Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik" kreu VIII, pika 2/b, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 3, "Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të

kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë.....” pika 5 dhe 6, “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”.

6.1 Rekomandoj:

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në zbatimin e kontratave dhe likuidimin e vlerave të mallrave të furnizuar të merren masat si vijon:

- Urdhër shpenzimet për vlerat e likuiduara nga autoriteti kontraktor për karburante, të shoqërohen, me faturat tatimore, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar për të vërtetuar cilësinë dhe standartet e furniturës dhe me deklaratën doganore SAD sipas kushteve të kontratës.
- Autoriteti kontraktor, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës, sipas deklaratës doganore SAD ose datës sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se MPJ në mënyrë sistematike kryen shpenzime me procedurë prokurimi për blerje materiale për pritje–përcjellje kryesisht kafe, ujë dhe çaj me bustina. Këto blerje për vitin 2016 janë realizuar nga subjekti privat “C..” në vlerën prej 1,800,000 lekë, të cilat janë kontabilizuar në debi të llogarisë 602 zëri “*pritje përcjellje*”. Krahas këtyre shpenzimeve, sipas programeve për çdo muaj kryhen përsëri shpenzime për pritje nëpërmjet subjektit privat “K.M”, për çdo takim që zhvillohen në ambientet e MPJ-së, të cilat për periudhën objekt auditimi kapin shumën prej 8,510,400 lekë.

Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se shpenzimet në total për pritje përcjellje të të gjitha kategorive për vitin 2015 kapin shumën prej 24,129,709 lekë dhe për vitin 2016 kapin shumën prej 53,999,451 lekë. Nga këto shpenzime, nuk janë veçuar shpenzimet brenda ambienteve të MPJ me qëllim kryerjen e një analize të veçantë për efektivitetin e shpenzimeve pritje e përcjelle që behën brenda ambienteve të MPJ-së në se duhet përdorur blerja e kiteve me procedurë të vogël apo kryerja e shërbimit për pritje e përcjellje nëpërmjet klubit privat të MPJ-së, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve procedurale.

7.1 Rekomandoj:

Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, të marrë masa për kryerjen e një studimi me qëllim përcaktimin e variantit efektiv të shpenzimeve për pritje përcjellje, nëpërmjet blerjes së kiteve nga një subjekti privat, apo shpenzimeve që kryhen në ambientet e klubit privat të MEPJ-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK), Njësia e Prokurimit (NJP) nuk ka funksionuar më vete në përbërje të strukturës organike, por gjatë vitit, si anëtar të NJP-ve, caktohen punonjës të ndryshëm, madje duke aktivizuar me pagesë edhe persona të tretë nga jashtë AK. Në këtë AK, ka zhvillime tenderash në një numër të konsiderueshëm dhe me procedura të ndryshme, duke përfshirë edhe tenderat e zhvilluar për blerje e shërbime të vogla si dhe ato të karakterit sekret. NJP-ja ka shumë përgjegjësira sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi. Nga NJP-të këto detyra nuk janë realizuar të gjitha dhe mangësitë e shkeljet e konstatuara, mund të ishin shmangur, shumica prej tyre, nëse NJP-ja do të funksiononte si strukturë më vete, si dhe po të ishin kryer edhe trajnimet e nevojshme pranë APP-së.

8.1 Rekomandoj:

Ministri, në varësi të burimeve njerëzore, që ka në dispozicion të shikojë mundësinë, për të ngritur funksionimin e strukturës së posaçme të prokurimit publik, e kjo në zbatim të nenit 57 “*Njësia e Prokurimit*” të VKM nr. 914, datë 29/12/2014, me qëllim

edhe të sigurimit të mirë përdorimit të fondeve publike dhe të uljes së shpenzimeve procedurale duke rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: AK, ka hartuar për periudhën objekt auditimi regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike sipas formatit të miratuar nga APP-ja dhe i ka dërguar zyrtarisht në APP-në, ku regjistrat e realizimeve janë plotësuar me mangësi, si: *vlerat e kontratave të lidhura dhe të realizuara janë raportuar pa tvsh-në; nuk janë raportuar disa tendera të zhvilluar e të realizuar gjatë viteve.* Mos kryerjet e këtyre veprimeve bien ndesh me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 9, pika 1 si dhe me udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit”, të dërguar çdo vit, pika 32 “Mbi limitet e angazhimit”.

Tenderat e pa raportuara në regjistrat e realizimit të prokurimeve janë si më poshtë:

- i) “*tendera të klasifikuara*”, ku sipas pikës 6 të LPP trajton Kontratat sekrete, kontratat të cilat kërkojnë masa të veçanta sigurie dhe kontratat, që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit, vetëm për përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, pra të procedurave të prokurimit;
- ii) “*shtesat e kontratave*”, të llojit të procedurës “*me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës*”, që janë bërë në fillim të çdo viti (20%), si: blerjet e karburanteve, riparimet e automjeteve, blerjet e biletave (për vitin 2015), ruajta e objekteve, etj. të kësaj natyre, madje edhe tendera të zhvilluara rregullisht, si blerje kafe dhe çaji.

9.1 Rekomandoj:

Njësia e Prokurimit për të ardhmen të marrë të gjitha masat, që në regjistrin e realizimit të tenderave të raportojë vlerën e kontratave duke përfshirë vlerën e tvsh-së. Gjithashtu në regjistrin e realizimit të tenderave të raportojë çdo tender të zhvilluar sipas procedurave përkatëse.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: AK, në shumicën e tenderave e në veçanti atë riparimit të automjeteve, procedurat i ka filluar me shumë vonesa, në muajin qershor dhe kontrata është lidhur në shtator, me një afat tepër të shkurtër për realizim vetëm prej 3 muajsh (*deri në fund të vitit*), duke lënë hapësira interpretimesh se të gjitha automjetet kanë pasur defekte dhe janë riparuar vetëm 3 muajt e fundit të vitit.

10.1 Rekomandoj:

Titullari i Autoritetit Kontaraktor, të marrë të gjitha masat, që procedurat e zhvillimit të tenderave të fillojnë që në fillim të vitit, duke vazhduar deri në momentin e lidhjes së kontratës, me kushtin, që kontrata të lidhet mbasi të jetë miratuar buxheti përkatës, siç përcakton legjislacioni i prokurimit publik.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në rastin e përllogaritjes së fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike, komisionet e ngritura me urdhra të titullarit, nuk kanë pasqyruar çdo veprim në procesverbal si dhe nuk kanë lënë gjurmë të përllogaritjes mbi të cilët janë bërë përllogaritjet dhe fiksimit e vlerave të fondeve limit. Madje nuk janë bërë korrektimet e fondeve limite (*zvogëlimit të fondit limit*) të hedhura në prokurim për ato tendera, që në fillim të vitit janë bërë shtesa kontratash (20%).

11.1 Rekomandoj:

Komisionet e ngarkuar me urdhër të titullarit për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike (*përfshijtur prokurimet për blerje e shërbime me vlerë të vogël*), të pasqyrojnë dhe dokumentojnë në çdo veprim për përllogaritjen e vlerës së kontratës dhe fiksimit e vlerave të tyre, bazuar në VKM nr. 914, datë 29/12/2014, neni 59 “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2, si dhe të bëjë

korrektimin në zbritje të vlerave për tenderat që janë bërë shtesa kontrata në fillim të vitit, (20% si shtesë kontrate), konform legjislacionin të prokurimeve.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit, nuk janë plotësuar nga anëtarët e KVO-ve, në afatin kohorë të momentit të hapjes së ofertave nëpërmjet platformës elektronike të faqes së APP-së. Këto deklarata janë plotësuar dhe nënshkruar me datën e daljes së urdhër prokurimit, në një kohë, që ofertat hapen nga KVO-të mbas disa ditëve (*datat e caktuar për dorëzimin e ofertave*). Kështu që deklaratimet përkatëse nuk janë bërë për pjesëmarrësit në konkurrim, pasi këto pjesëmarrës në prokurim njihen vetëm në ditën e hapjes së ofertave nëpërmjet platformës elektronike të faqes së APP-së.

12.1 Rekomandoj:

Anëtarët e KVO-ve të plotësojnë dhe nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit vetëm në datën e dorëzimit të ofertave (*hapjes së zhvillimit të procedurës së vlerësimit të dokumenteve të OE nëpërmjet faqes së APP-së*).

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nuk janë lënë gjurmë në asnjë tender se cili nga anëtarët e KVO-ve është specialist i fushës së objektit të tenderit të zhvilluar si dhe anëtarët për anëtarët e NJP-ve, nëse e kanë arsimin e lartë përkatës, siç përcakton rregullorja e prokurimit publik në fuqi.

13.1 Rekomandoj:

Titullari i AK të marri të gjitha masat, që në dosjet e tenderave të cilësojnë emrin e anëtarit të KVO-së si specialist i fushës së objektit të tenderit si dhe për anëtarët e NJP nëse janë më arsim të lartë.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Vendosja e disa kërkesave kualifikuese dhe miratimi i tyre nga NJP-të, kanë mangësi të konsiderueshme dhe disi të ekzagjeruar dhe krejtësisht të pa argumentuara, të cilat janë me risk të lartë, natyrisht duke parë, që në këtë AK, në tenderat e zhvilluar, kanë rezultuar se kanë marrë pjesë shumë pak operator ekonomik konkurrues, janë s'kualifikua shumica e konkurrenteve, duke mbetur vetëm me nga një konkurrues, madje në disa tendera janë fituar për disa vite rresht po nga i njëjti operator ekonomik konkurrues, si dhe fituesit janë shpallur shumë afër vlerave të fondeve limit të vënë në dispozicion për konkurrim, etj. të kësaj natyre, të cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ku më kryesorët i përmendim:

a) nuk ka argumentim vendosja e miratimi i kërkesave të veçanta të kualifikimit në procesverbalet e hartimit të dokumenteve të tenderave të përgatitura nga NJP-të, veprim që bie ndesh me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 61, pika 2;

b) kërkesat e veçanta kualifikuese të hartuara në kundërshtim me rregullat e prokurimit, janë:

i) nuk ka cilësime në se është i zbatueshëm sigurimi i ofertës, sipas shtojcës 3 të DST, pasi sipas rregullave të prokurimit publik në fuqi i është lënë në kompetencë AK-së për të vendosur një gjë të tillë, nisur nga vlera më të lartë se kufiri i lartë monetar. Gjithashtu as në paketën e dokumenteve të tenderave të përgatitura nga AK-ja e të hedhura në platformën elektronike të faqes së APP-së, Seksioni 3 “*Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik*”, pika 3.2 “*Sigurimi i Ofertës*”, nuk ka sqarime nëse duhet bërë sigurimi i ofertës apo jo;

ii) në Seksionin “*Kapacitetit ligjor i operatorëve ekonomikë*”, të kërkesave të veçanta të kualifikimit, NJP-të kanë kërkuar si dokumente prove po ato dokumente të miratuar nga APP-ja me DST, për plotësimin e kërkesave të përgjithshme të kualifikimit, veprim që bie ndesh me LPP, neni 46 “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika 1, germa (ç), që sqaron shumë qartë se me kapacitet ligjor kuptohet operatorët ekonomikë konkurrues të vërtetojnë se kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës. Madje ky seksion i kërkesave kualifikuese të veçantë

ndryshojnë, nga kërkesat e përgjithshme të kualifikimit si nga afati kohorë i paraqitjes së dokumentacioneve ashtu edhe në konkurrimin që bëhet me bashkim operatorësh ekonomik;

iii) në Seksionin “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, NJP-të kanë interpretuar gabim mënyrën e plotësimit të kërkesës së veçante të kualifikimit për të paraqitur kopje të deklaratës së xhiros mesatare vjetore të realizuar gjatë një viti më parë, në një kohë që në praktikën e punës nuk ka realizim mesatar vjetor për një vit kalendarik, të cilësuar shumë qartë në nenet 26, 27 dhe 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, çka i kanë vënë në vështirësi OE si dhe KVO-të;

iv) në Seksionin “*Kapaciteti teknik dhe profesional*”, NJP-të kanë kërkuar si kërkesa të veçanta të kualifikimit, që OE duhet të demonstrojnë se zotërojnë certifikata të ndryshme cilësie ISO. Kërkesa për të tilla certifikata nuk janë konformë rregullave të prokurimit publik, e konkretisht nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29/12/2014, pikat 1 dhe 2, pasi disa certifikata të kërkuara nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektet e kontratave si dhe nuk janë cilësuar, që certifikatat e lëshuara nga organet e pavarura të jenë njohur më parë nga sistemet kombëtare ose ndërkombëtare, pra duhej të paraqisnin dokument të sistemit të standardizimit shqiptar ose edhe ndërkombëtar për njohjen se cilat kompani kanë të drejtë të lëshojnë certifikata të tilla;

v) për rastet, kur NJP-të kanë kërkuar, që OE duhet të dorëzojë pranë AK mostra të copave, kampionë të materialeve mbushëse, të paneleve dhe të materialeve të tjera, që janë realizuar mobilet dhe ndenjëset për zyra, apo të kondicionerëve, apo të pjesëve të këmbimit, të riparimit të automjeteve, etj. të kësaj natyre, nuk janë kryer konformë rregullave të prokurimit publik në fuqi. Nuk janë bërë cilësimet se këto materiale për prezantim duhej të ishin paraqitur para se të hapej procedura e prokurimit publik, sepse nqse nuk prezantohej mostra e tyre, atëherë nuk ka përse të shikohen më praktikat dokumentare të tillë konkurrentëve.

Gjithashtu nuk u është cilësuar shpjegimi i DST, që konkurrentëve për rikthimin e këtyre mostrave, do të bëhet vetëm me kërkesën e tyre brenda 30 ditëve, si dhe nuk ka dokument për të vërtetuar se çfarë është bërë më tej me këto mostra të marra, siç kërkon VKM nr. 914, datë 29/12/2014, pika 6, germa (a);

vi) për rastet, kur NJP-të kanë kërkuar, që OE duhet të dorëzojë pranë AK deklarime doganore, nuk janë cilësuar afati kohorë i plotësimit të tyre, pra me data mbas momentit të hapjes së procedurave të tenderave, apo çfarëdo lloj periudhe kohore, sepse dokumentet e tilla për të vërtetuar këtë kërkesë të veçantë të kualifikimit kanë afat kohorë deri në 3 vite, natyrisht, që të tregonin sa më mirë realitetin e gjendjes së mallrave dhe konkurrimi të realizohet me bazë të njëjtë krahasimi.

14.1 Rekomandoj:

AK, Njësitë e Prokurimit të marrin të gjitha masat për të ardhmen, që:

-Në procesverbalet e hartimit të dokumenteve të tenderave dhe vendosjen e kërkesave kualifikuese e specifikimeve teknike, detyrimisht të bëjnë argumentimet dhe përlllogaritjet e vendosjeve të kërkesave të veçanta të kualifikimit;

-Në çdo tender të zhvilluar të cilësojë nëse është e zbatueshme dhe nëse është e nevojshme sigurimi i ofertës;

-Në Seksionin e “*Kapacitetit ligjor të operatorëve ekonomikë*”, të kërkesave të veçanta të kualifikimit, NJP-ja të mos vendos për herë të dytë kërkesat e përgjithshme të kualifikimit, por të vendosin kërkesat që përcakton neni 46 i LPP, që operatorët ekonomikë konkurrues të vërtetojnë se kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës;

-Në Seksionin “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, NJP-ja të vendos kërkesën kualifikuese të veçantë për të paraqitur kopje të deklaratës së xhiros mesatare dy ose 3 vjeçare ose xhiron vjetor të vitit përkatës, konformë neneve 26,27 dhe 28 të VKM nr. 914, datë 29/12/2014;

-NJP-të kur e gjejnë të nevojshme miratimin e kërkesave kualifikuese të veçanta, si:

*Në Seksionin “*Kapaciteti teknik dhe profesional*”, për demonstrimin se duhet të zotërojnë certifikata të ndryshme cilësie ISO, atëherë detyrimisht kërkesa për llojin e

certifikatave ISO duhet të jetë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektet e kontratave që prokurohen si dhe këto certifikata të jenë njohur më parë nga sistemet e standardizimit shqiptar ose edhe ndërkombëtar, këto konformë neni 30 të VKM nr. 914, datë 29/12/2014;

**Paraqitjen e mostrave, detyrimisht të fiksojë datën para së të realizojë hapjen e ofertave të OE për të paraqitur mostrat përkatëse si dhe tu sqarojë në paketën e DST se këto mostra do tu kthehen, ku si për paraqitjen e mostrave ashtu edhe për dorëzimin e tyre brenda 30 ditëve të shoqërohen me praktika të rregullta dokumentare, kjo konform VKM nr. 914, datë 29/12/2014, pika 6.*

**Paraqitjen e deklaratave doganore, detyrimisht të fiksojë edhe afatet kohore të tyre, si dhe të cilësojë se për cilin mall duhet deklaratë doganore. Gjithashtu kërkesa për paraqitje autorizimi nga kompanitë prodhuese apo bazat e furnizimit për tregtim mallrash, duhet kërkuar vetëm me afat kohorë përdorimi të tyre.*

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për rastet kur tenderat janë anuluar, pasi janë refuzuar të gjitha ofertat dhe vendosur përsëritja nga e para, nuk ka ndonjë procesverbal të mbajtur nga NJP-të për analizën përmirësimit të praktikave dokumentare, për ta filluar nga e para, siç cilëson LPP, Kreu II, neni 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, pika 2, germa (ë).

15.1 Rekomandoj:

Titullari i Autoritetit Kontraktor për të ardhmen të marrë të gjitha masat për të analizuar shkaqet që e kanë çuar në anulimin e tenderave dhe të lejë gjurmë për përmirësimet e bëra në dokumentet e tenderave që do të prokurojë për herë të dytë.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Për të gjithë tenderat e audituar, NJP-të nuk kanë evidentuar marrjet në dorëzim të paketave të dokumenteve të fitueseve të tenderave, para se të lidhen kontratat përkatëse. Mos kryerja e këtij veprimi bie ndesh me LPP, Kreu II, neni 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, pika 3, si dhe VKM nr.914, datë 29/12/2014, i ndryshuar, neni 64, pika 5.

16.1 Rekomandoj:

Titullari i AK, të marri të gjitha masat për të ardhmen, që para se të lidhen kontratat me fituesit e tenderave, të nxjerrë urdhrin për NJP për ti kontrolluar të gjitha praktikat dokumentare të paraqitur fizikisht me ato me ato të raportuara në platformën elektronike të faqes së APP-së dhe ti dokumentojnë marrjet e tyre në dorëzim nga OE fitues i tenderit, konform legjislacionit të sipër cilësuar.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në procesverbalet e vlerësimeve të procedurave të prokurimit të plotësuara nga KVO-të nuk janë cilësuar nëse janë kryer veprimet aritmetikore si dhe nëse janë bërë përllogaritjet e vlera anomalish të ulët, në zbatim të formulës përkatëse të miratuara me DST, siç cilëson VKM nr. 914, datë 29/12/2014, i ndryshuar, neni 66, pikat 4 dhe 5.

17.1 Rekomandoj:

KVO-të në procesverbalet e vlerësimit të praktikave dokumentare të operatorëve ekonomik konkurrues pjesëmarrës në tenderat përkatës, të japë shpjegime për kryerjet e veprimeve aritmetikore si dhe të trajtojë përllogaritjet duke paraqitur edhe formulën përkatëse të zbatuar për përllogaritjen e vlerave anomalisht të ulët, kjo konformë legjislacionit të prokurimit publik të sipër cilësuar.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Të gjithë fituesit e tenderave janë shpallur nga AK pa plotësuar 100% kërkesat kualifikuese të një forme apo të një forme tjetër, në një kohë, që shumica e tenderave

në këto raste duhej të ishin anuluar, studiuar shkaqet dhe pasi të përmirësonin vendosjen e kërkesave kualifikuese të shpallë nga e para. Këta fitues ose kanë mbetur konkurrues të vetëm ose janë shpallur fitues, në një kohë që janë s'kualifikuar konkurruesit e tjerë, të cilët kanë pasur vlerat e konkurrimit më të ultë se fituesit e shpallur. AK-ja nuk ka vepruar drejt në zbatim të nenit 53, pika 4, për devijime të vogla, duke qenë se NJP-të kanë vendosur si kriter vlerësues “çmimit më të ulët”, çka KVO-të i kanë sjellë kësaj njësie shpenzuese kryerje të mbi shpenzimeve të pa argumentuara, pa efektivitet dhe pa efikasitet.

18.1 Rekomandoj:

KVO-të të klasifikojnë vetëm ato OE pjesëmarrës në tenderat që plotësojnë 100% kërkesat kualifikuese si dhe specifikimet teknike. Në rastet kur asnjë nga OE konkurrues nuk plotësojnë 100% kërkesat kualifikuese dhe specifikimet teknike dhe KVO vazhdon procedurën, atëherë mund të zbatohet neni 53, pika 4 të LPP vetëm për ato OE, që janë paraqitur me vlerën më të vogël, në zbatim të kërkesës vlerësuese të “çmimit më të ulët” të miratuar nga NJP, me kushtin që para se të lidhen kontratat të bëhen korrigjimet e duhura të devijimeve të vogla duke bërë argumentimin për çdo rast në procesverbalet përkatëse, në të kundërtën të anulohet tenderat.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Inventarët e dosjeve të tenderëve të zhvilluara nuk kanë të shënuar marrësin në dorëzim dhe dorëzuesit përkatës, konformë ligjit të arkivave. Gjithashtu konstatohet se në dokumentet e tenderëve pa përjashtim janë përfshirë shumë kopje të një dokumenti, çka i ngarkojnë dosjet përkatëse me materiale të pa nevojshme dhe tepër voluminoze.

19.1 Rekomandoj:

NJP-ja të arkivojnë dosjet për tenderat e zhvilluar gjatë viteve 2014 dhe 2015 në arkivin e ministrisë si dhe të heqin nga çdo dosje kopjet e dubluara, duke lënë vetëm një kopje të dokumenteve përkatës, kjo konformë ligjit të arkivave.

Brenda datës 31/10/2017

20. Gjetje nga auditimi: Grupet e auditimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm Të MPJ, për auditimet e kryera në njësitë shpenzuese vartëse (*ambasadat, konsullatat dhe misionet e ndryshme shqiptare jashtë Shqipërisë*), kanë konstatuar si gjetje shpenzime të bisedave falas të kryera nga titullarët e këtyre njësive. MPJ ka dërguar udhëzime e qarkore në lidhje me zbatimin e VKM nr. 864, datë 23/7/2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik”, i ndryshuar, duke fiksuar kuotat përkatëse mujore duke cilësuar se tejkalimi i kuotave mujore nuk do të kompensohen gjatë vitit kalendarik. Audituesit kanë njohur kompensimet e muajve gjatë vitit, kur ka pasur tejkalime të kuotave mujore. Audituesit e brendshëm kanë vënë para përgjegjësisë këto persona duke i konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit nëpërmjet llogaritjeve të kompensimeve vjetore.

20.1 Rekomandoj:

Ministria, në udhëzimet dhe qarkoret e dërguara njësive shpenzuese të bëjë ndryshimet përkatëse, duke saktësuar se tejkalimi i kuotave mujore të shpenzimeve telefonike nuk do të kompensohen në muajt e tjerë gjatë vitit kalendarik.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Grupet e auditimit të brendshëm për rastet, kur kanë konstatuar mbi shpenzime të pa argumentuara dhe kanë fiksuar vlerat përkatëse si dëme ekonomike për buxhetin e shtetit, për punonjësit që nuk janë më në marrëdhënie pune me subjektin e audituar (*punonjësit e ambasadave dhe konsullatave kanë lëvizje të shpeshta nga një shtet në shtetin tjetër*) nuk njoftojnë më për arkëtimin e dëmit ekonomik të konstatuar, por e kanë bërë praktikë pune, që ia dërgojnë Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë Ekonomike pranë MPJ. Për këto të tilla

detyrime nuk janë bërë programe verifikimi siç programohen zbatimet e rekomandimeve të tjera.

21.1 Rekomandoj:

Drejtoria e Auditit të Brendshëm të bëjë verifikimet e nevojshme herë pas here duke i programuar edhe në planet vjetore të auditimit dhe të nxjerrë përgjegjësinë për personat përkatës të dy drejtorive në rast se nuk është bërë ndonjë përpjekje për arkëtimin e dëmeve ekonomike.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Në auditimine e kryer nga audituesit e brendshëm, të veprimtarisë financiare së përhershme të RSH-së në NATO, është konstatuar marrja me qira e tre apartamenteve, të cilat nuk janë më në përdorim nga përfaqësia, por ka mbetur e bllokuar shuma e vlerës së ngurtësuar prej **5,640** euro. Nga Përfaqësia e RSH në NATO dhe Misioni i RSH pranë BE nuk u janë vënë në dispozicion dokumentacioni i plotë për mënyrën e zgjidhjes së këtyre kontratave dhe detyrimet, që kanë mbetur pa shlyer apo arsyen e bllokimit të shumave të ngurtësuar. Nuk ka rezultuar që të ketë një korrespondencë zyrtare midis përfaqësisë së RSH-së në NATO dhe MPJ për këtë çështje. Për këtë nga grupit të auditimit të brendshëm është lënë Rekomandoj: *“që përfaqësia e përhershme e RSH në NATO në bashkëpunim me ambasadën e RSH në Mbretërinë e Belgjikës dhe misioni i përhershëm i RSH pranë Bashkimit Evropian të ngrenë një grup pune për sqarimin e problematikave të kësaj çështje duke shkëmbyer informacionin e nevojshëm. Ky grup duhet të përgatisë dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Programimit Buxhetor dhe Financës dhe Drejtorisë së Auditimit në MPJ informacion të hollësishëm dhe masat e nevojshme që do të merren për zgjidhjen e kësaj çështje”*. Në fakt audituesit duhej ta kishin audituar në vend këtë çështje duke i propozuar titullarit të ministrisë për një shtyrje afati verifikimi dhe kjo çështje duhej të ishte mbyllur përfundimisht rezultatit konkretë.

22.1 Rekomandoj:

Drejtoria e Auditimit të iniciojë pranë ministrit një mision auditimi për të bërë verifikimet e nevojshme dhe nxjerrjen e konkluzioneve deri në saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së ngurtësuar, duke vënien para përgjegjësisë punonjësit përkatës,.

Brenda datës 30 Tetor 2017

23. Gjetje nga auditimi: Në auditimine e kryer nga audituesit e brendshëm të MPJ, të veprimtarisë financiare së Misionit të RSH pranë OKB-së dhe aktivitetit të Konsullatës së RSH në Nju-Jork (*N.Y-e mbyllur*), ka konstatuar si gjetje pagim penaliteti për objekt qiraje, të vlerës prej **12,000** USD, të një godine, që kishte administruar konsullata. Kontrata e lidhur që në fillim vitit 2006 nga z. J, i cili aktualisht është në marrëdhënie pune me MPJ, është lidhur me gabime e risk të lartë, si pa shënuar afatin përkatës, dhe më vonë me një kontratë e rilidhur në Mars 2013 nga z. D.M. (aktualisht i larguar nga MPJ) nuk është bërë rishikimi apo ndryshimi përkatës i kushteve të kontratës. Pra vlera e ngurtësuar është dëm ekonomik për shtetin pasi apartamenti nuk përdoret më dhe misioni është mbyllur.

Audituesit këtë vlerë duhej ta kishte konsideruar dëm ekonomik, duke ja ngarkuar përgjegjësinë lidhësit të parë të kontratës si dhe punonjësit tjetër që ka rilidhur kontratën pa asnjë lloj ndryshimi, (respektivisht Z. J. dhe z. D.M).

Rekomandoj i lënë nga DAB, që kontratat për të ardhmen duhet të lidhen pasi të jetë marrë miratimi juridik më parë nga MPJ, nuk i shërben efektivitetit ekonomik të vlerave të përdorura.

23.1 Rekomandoj:

Drejtoria e Auditimit të iniciojë ministrin për të kryer një mision auditimi për të bërë verifikimet e nevojshme dhe nxjerrjen e konkluzioneve, vënien para përgjegjësisë të personave përgjegjës, deri në arkëtimin e vlerës si pagim penaliteti, nqse nuk ka argumentim dokumentar.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer nga audituesit e brendshëm, për veprimtarisë financiare të Ambasadës së RSH-së, në Ankara-Turqi, janë konstatuar mjaft mangësi e shkelje në kuadrin e zbatimit të projektit të Qendrës Kulturore Shqiptare (QKSH) në Ankara, në zbatimin e ligjin nr. 7982, datë 21/12/1994 “*Për sponsorizimet*”.

MPJ për këtë auditim ka bashkëpunuar me APP-në si dhe Inspektimin Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave, ku kjo e fundit i ka kthyer përgjigje që kemi të bëjmë me dëme ekonomik në vlerën prej **4,210.34** EURO dhe **3,018.6** lira turke, nga financimi i bërë nga QKSH-ja në vlerën prej **20,125** EURO për 3 vite, sipas nenit 5 të memorandumit. Në materialet e auditimit cilësohen edhe shpenzime të tjera të kryer nga ky projekt për shpërblime punonjësish të ambasadës pa marrë më parë miratimin e MPJ.

24.1 Rekomandoj:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, materialin e audituar për veprimtarinë financiare të Ambasadës së RSH-së, në Ankara-Turqi, në kuadrin e zbatimit të projektit të Qendrës Kulturore Shqiptare në Ankara, ta dërgojë pranë organeve të prokurorisë për vlerësim të elementeve penale.

Brenda datës 30 Tetor 2017

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, Sektori i Financës për çdo muaj rimbursos shpenzimet për telefona celularë për 7 punonjës duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë 602 në shumën prej 140,000 lekë/muaj pa justifikuar me faturën mujore për shpenzimet faktike, me qëllim kryerjen e pagesave sipas faktit dhe jo sipas limitit që përcaktohet në këtë vendim. Ky veprim është kundërshtim me VKM nr.864, datë 23.7.2010, “*Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë*” pika 15, ku përcaktohet se: “*Në çdo rast, shërbimi i ofruar nga institucioni paguhet sipas faturës mujore për vlerën e shpenzuar. Çdo tejkalim i limitit mujor, të përcaktuar sipas pikave 3-9 të këtij vendimi, nuk kompensohet me limitin e muajit pasardhës dhe përballohet nga vetë personi zyrtar*”.

25.1 Rekomandoj:

Nga MEPJ, Sektori i Financës të merren masa të menjëhershme që në vijimësi të gjitha shpenzimet për telefona celularë të rimbursohen sipas faturës së shpenzimeve faktike, konform pikës 15 të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “*Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë*”.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit për blerjen e biletave, u konstatuan mangësi dhe të meta që bien në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 18.02.2008 “*Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla*”, pasi çdo blerje bilete udhëtimi me avion ishte kryer vetëm me urdhrin e titullarit apo të Sekretarit të Përgjithshëm nëpërmjet të cilit është autorizuar Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Çështjeve Konsullore dhe Diasporës për marrjen e masave për zbatimin e urdhrin. Kjo mënyrë formulimi e urdhrave të mësipërm nuk ka përcaktuar asnjë përgjegjësi konkrete apo direkte për respektimin e dispozitave ligjore për zbatimin e rregullave për blerjen e biletave nëpërmjet procedurave prokuruese, siç përcaktohet në dispozitat ligjore “*Për prokurimin Publik*”.

Krahas këtyre mangësive, në shumë raste konstatohet se, urdhri për blerjen e biletave ka dalë pas blerjes së biletave, madje në disa raste urdhrat e blerjes janë nxjerrë me shumë vonesë deri 3 muaj pas blerjes së biletave, fakt që tregon se biletat për udhëtim jashtë shtetit janë blerë pa dalë urdhri i titullari, duke mos respektuar në këtë mënyrë kërkesën më minimale që është urdhri i prokurimit i lëshuar nga personi i autorizuar nga titullari i Autoriteti Kontraktor.

26.1 Rekomandoj:

Nga titullarët e MEPJ të merren masat në mënyrë që në formulimin e urdhrave për blerjen e biletave për udhëtimet ajrore të përcaktohet përgjegjësia konkrete apo direkte

për respektimin e dispozitave ligjore dhe e rregullave për blerjen e biletave nëpërmjet procedurave prokuruese, siç përcaktohet në dispozitat ligjore “Për prokurimin Publik”.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 985/7, dt. 04.01.2013 rezultoi se në zbatim të Rekomandojt nr. 9 “Të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm por që nga verifikimi i tyre rezultuan të pa zbatuara, apo në proces zbatimi, si dhe për të gjitha rekomandimet, për të cilat janë nxjerrë urdhrat e zhdëmtimit në datë 24.12.2012, të kryhet kontabilizimi dhe të fillojë arkëtimi i detyrimeve, deri në ndjekjen, në rrugë ligjore të arkëtimit të dëmeve ekonomike, sipas trajtimit të bërë në faqet 43-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit” MPJ për punonjësit të cilat duhet të arkëtojnë shumat e lëna në ngarkim është dërguar shkresa pranë përfaqësive përkatëse. Vlera e mësipërme nuk është kontabilizuar dhe nga 200 punonjës në vlerën 40,400 EURO është arkëtuar vlera 27,143 EURO për 107 punonjës. Mbetet pa u arkëtuar vlera 13,257 EURO.

27.1 Rekomandoj:

Nga MEPJ, Përfaqësitë Jashtë Shtetit dhe Sektori i Financës të merren masa të menjëhershme që vlera e mbetura pa arkëtuar prej 13,257 EURO të kontabilizohet dhe të fillojë procedura e arkëtimit të detyrimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Dëmi ekonomik i shkaktuar është në shumën 16,928,125 lekë dhe 150 EURO për të cilin kërkohet të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i saj, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Me anë të Memorandumit Nr. 454, datë 30.01.2014 të cilit i janë bashkëlidhur vendimet e ish Sekretarit të Përgjithshëm, Q.Q, janë kaluar në listë pritje punonjësit të cilëve u është prekur vendi i punës si pasojë e ristrukturimit të institucionit në zbatim të urdhrat të Kryeministrit nr. 227, datë 02.12.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MPJ”.

Nga auditimi i listë pagesave dhe nëpunësve të cilët trajtohen me statusin e nëpunësit civil u konstatua se për periudhën 01.01.2014 deri në 24.02.2015 kanë përfituar nga lista e pritjes 44 punonjës dhe ish punonjës të Ministrisë së Punëve të Jashtme sipas listë pagesave të deklaruara në shumën 22,419,502 lekë bruto, dhe neto në vlerën 17,851,033 lekë.

Në nenin 50 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 për sistemimin e punonjësve në vende vakante është përcaktuar se ... Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.

Transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me precedencë, sipas kësaj renditjeje: a) në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; b) në institucionin, me të cilin institucioni është shkrirë apo bashkuar, në një nga institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; c) në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar; ç) në një institucion tjetër të shërbimit civil.”.. VKM nr. 171, datë 26.3.2014, Kreu III.

Në Ligjin 152/2013, datë 30.5.2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, konstatohet se termi “Listë pritje”, nuk ekziston. Nën këtë arsyetim pagesat e kryera nga MPJ për punonjësit në “Listë

pritje” është në kundërshtim me ligjin e mësipërm dhe vlera prej 15,833,657 lekë (*Mars 2014 deri mars 2015*) përbën dëm ekonomik për Institucionin dhe duhet të arkëtohet.

1.1 Rekomandoj:

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **15,833,657** lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, të përfituar padrejtësisht për shkak të trajtimit të tyre si punonjës në *“listë pritje”* nga 44 punonjës dhe ish punonjës të Ministrisë së Punëve të Jashtme sipas listë pagesave të deklaruara (*bashkëlidhur*) për vitin 2014 dhe 2015 në kundërshtim me Ligjin 152/2013, datë 30.5.2013 *“Për statusin e nëpunësit civil”*.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në likuidimin e vlerës së karburantit gazoil dhe benzinë të furnizuar nga subjekti “K” sh.a. rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratave për furniturat bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datat përkatëse të furniturave referuar deklaratave doganore SAD duke sjellë pagesë të tepërt në vlerën 274,218 lekë e cila duhet të arkëtohet pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

2.1 Rekomandoj:

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **274,218** lekë nga OE “K” sha. duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, të përfituar padrejtësisht si rezultat i mos respektimit të çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturat bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datat përkatëse të furniturave referuar deklaratave doganore SAD në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Sipas Urdhrit të Ministrit të punëve të Jashtme nr. 22, dt. 25.01.2016, anëtarët e Komisionit të posaçëm të shpronësimit të një pjese të pasurisë *“Ofiçina e Automjeteve Tiranë”* kanë përfituar në mënyrë të pa drejtë vlerën prej 800,000 lekë, vlerë e destinuar për shpenzimet procedurale të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë shpenzimet e procedurës së shpronësimit në kundërshtim me VKM nr. 1044, dt. 16.12.2015 *“Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës “Mbi reciprocitetin e godinave ku akomodohen përfaqësia diplomatike e Republikës Popullore të Kinës Tiranë” nënshkruar më 10.04.1960”*.

3.1 Rekomandoj:

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **800,000** lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, të përfituar padrejtësisht si shpërblim në kundërshtim me VKM nr. 1044, dt. 16.12.2015 nga anëtarët e komisionit:

Z. S.B., kryetar, në vlerën prej 140,000 lekë.

Z. Q.Q, anëtar, në vlerën prej 140,000 lekë.

Znj. E.H, anëtare, në vlerën prej 140,000 lekë.

Z. B.E, anëtar, në vlerën prej 140,000 lekë.

Z. S.G, anëtar, në vlerën prej 140,000 lekë.

Znj. F.M, Sekretaria teknike, në vlerën prej 50,000 lekë.

Znj. E.S, punonjëse e ALUIZNI-t në vlerën prej 50,000 lekë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Me mandat pagesën nr. 156, datë 11.05.2015 është paguar eksperti i jashtëm F.D.B, Drejtor i Studimeve Evropiane në Departamentin e Universitetit Graz Austri,

në shumën prej 1,000 euro, sipas urdhrit nr. 103, datë 17.04.2015 nënshkruar nga z. Q.Q. ish Sekretar i përgjithshëm i MPJ, me objekt shlyerjen e pagesës ndaj z. F.B: “*Hartimin e një artikulli analitik për konferencën “Freedom of Expression and Media”*”, pa ndalur tatimin në burim në masën 15 % mbi të ardhurat në shumën prej 150 Euro, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “*Për Tatimin mbi të Ardhurat*”, i ndryshuar me ligjin nr. 9716, datë 16.04.2007, neni 4, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” i ndryshuar. (Nuk ka marrëveshje me shtetin austriak për përjashtimin e taksimit të dyfishtë).

6.1 Rekomandoj:

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të merren masat për nxjerrjen e përgjegjësisë dhe për arkëtimin e shumën prej **150** euro, për sa përfituar padrejtësisht nga F.D.B, Drejtor i Studimeve Evropiane në Departamentin e Universitetit Graz Austri.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi me zgjedhje i shpenzimeve për pritje e përcjellje të kryera nëpërmjet “*K.M*”, dhe dokumentacionit bashkëlidhur faturave të shërbimit të paraqitur nga ky subjekt, në 4 raste u konstatuan veprime shumëzime dhe mbledhje të gabuara, duke sjellë si pasojë përfitim të padrejtë nga subjekti privat në shumën prej **20,250** lekë. Kjo mangësi ka ardhur si rrjedhojë e moskryerjes së funksionit kontrollues pas faktit siç përcaktohet në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, Neni 4 “*Përkufizime*”, pika 18 ku përcaktohet: “*Kontrolle pas faktit*” janë kontrolle të herëpashershme, që ushtrohen pas përfundimit të transaksionit, sipas një plani apo në vijim të një kërkesë. Kontrollat pas faktit verifikojnë nëse fondet publike arkëtohen e shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, si dhe për arritjen e rezultateve të pritshme nga përdorimi i fondeve publike; si dhe pika 19 “*Gjurma e auditimit*”, përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë.

7.1 Rekomandoj:

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **20,250** lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, të përfituar padrejtësisht nga subjekti privat “*K.M*”, si rrjedhojë e veprimeve të gabuara aritmetikore.

Menjëherë

C. GJETJE ME EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN PA EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Janë likuiduar shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore sipas 12 Urdhër Shpenzimeve për vitin 2015 në shumën 10,017,885 lekë, 11 Urdhër Shpenzimeve për vitin 2016 në shumën 8,198,765 lekë dhe 4 Urdhër Shpenzimeve në katër mujorin e vitin 2017 në shumën 915,242 lekë.

E gjithë shuma prej **19,131,892** lekë për ekzekutimin këtij vendimi gjyqësor është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit duke qenë se i përket vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna.

2. Gjetje nga auditimi: Në kuadër të zbatimit të projektit të miratuar “*Përforcimi i kapaciteteve të diplomacisë publike dhe ekonomike të Ministrisë së Punëve të jashtme*” si bashkëpunim i Qendrës së Ekselencës me Ambasadën Zvicerane nga Ministria janë kontraktuar konsulentë të jashtëm për hartimin e artikujve analitikë. Me Urdhër Shpenzimet janë likuiduar

sipas subjekteve përfitues vlera për konsulenca dhe artikuj studimore për vitet 2015 dhe 2016 në vlerën **5,018,485** lekë.

Për procedurën zbatimin dhe monitorimin e kontratës nuk ka dosje të veçanta me dokumentacionin përkatës për çdo fitues në kundërshtim me UM nr. 344, dt. 15.06.2015 “Për krijimin e zyrës së projekteve/qendrës së ekselencës, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme” dhe rregullores përkatëse e përcaktuar në lidhjen nr. 1 “Rregullorja e Qendrës së Ekselencës në Ministrinë e Punëve të jashtme dhe Drejtoria e programit Buxhetor dhe Financës”.

3. Gjetje nga auditimi: Në MPJ, në strukturën organike me detyrën e Drejtores së Drejtorisë së Brendshme janë paguar dy punonjëse, pasi ish Drejtori është larguar nga detyra përkatëse, e cila me vendim gjyqësor ka fituar të drejtën për tu kthyer në detyrë, gjë e cila nuk është realizuar nga kjo ministri dhe është emëruar si audituese. Emërimi është si audituese kurse paga i llogaritet në pozicionin e Drejtores duke i dhënë diferencën, ku për këtë periudhë kohore ka marrë shtesën neto prej **1,101,609** lekë.

Po në vazhdim të kësaj periudhe është emëruar Drejtorja e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, në kundërshtim me ligjet nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010 si dhe ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Kreu IV “Organizimi i auditimit të brendshëm”, Neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm”, germa (b), pasi në momentin e emërimit si drejtuese e njësisë së auditit të brendshëm nuk plotëson njërin nga dy kushtet e posaçme, sepse nuk ka përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm si rezultat është kryer një shpenzim prej **1,101,466** lekë pa ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike.

4. Gjetje nga auditimi: Komisionet e Vlerësimit të Ofertave për prokurimet publike kanë shpallur fituesit e tenderave pa plotësuar 100% kërkesat kualifikuese si dhe kanë raste të s’kualifikuar të OE, që janë paraqitur në konkurrim me vlera më të vogla se fituesit, në një kohë që këto tendera duhej të ishin anuluar dhe studiuar arsyet e anulimit të tyre si dhe duhej përsëritur procedurat e prokurimit nga e para, pasi nuk ka pasur asnjë konkurrent me plotësim 100% të kërkesave kualifikuese, por një veprim i tillë nuk është kryer duke shkaktuar shpenzime kontraktore në vlerën e plotë **25,760,940** lekë pa ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike.

D. MASA DISIPLINORE.

Në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara më poshtë por edhe shkeljet e tjera të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet titullarit të institucionit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore sipas përgjegjësisë individuale të drejtuesve:

Z. Q.Q, ish Sekretari i Përgjithshëm,

Znj. B.K, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse,

Znj. I.D, Drejtori i Planifikimit të Buxhetit dhe Financës;

Pasi:

1. Në zbatimin e procedurave të blerjes së automjeteve për përfaqësitë Shqiptare jashtë shtetit janë konstatuar:

a. Me Urdhër shpenzimin nr. 139, dt. 21.10.2014 është transferuar fondi për llogari të ambasadave në vlerën 21,158,635 lekë për blerje automjesh.

Mbështetur në VKM nr. 53, dt. 21.01.2009 “Për ngarkimin e ministrisë së brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë për disa mallra e shërbime” i ndryshuar (shfuqizuar me VKM nr. 28, dt. 14.01.2015) pika 1. Ngarkohet e Ministria e Brendshme, si organ qendror

blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të kryeministrit e të ministrive të linjës, për blerjen e mallrave dhe shërbimeve si..... Blerje automjetesh, etj... Procedura e blerjes së këtyre automjeteve nuk është kryer e përqendruar nga Ministria e Punëve Brendshme.

Urdhër shpenzimi për transfertën është firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm Q.Q dhe Drejtori i Planifikimit të Buxhetit dhe Financës I.D.

b. Me Urdhër shpenzimin nr. 180, dt. 31.12.2014 është transferuar fondi për llogari të ambasadave në vlerën 30,000,000 lekë për blerjen e automjeteve për përfaqësitë.

Ky fond është transferuar për ambasadat e mëposhtme në vlerën 211,348 EURO; Misioni NATO-s Bruksel për 150,000 EURO. Misioni i BE-së Bruksel për 61,348 EURO. Ky urdhër shpenzimi për transfertën është firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm Q.Q dhe Drejtori i Planifikimit të Buxhetit dhe Financës I.D. Ky fond është transferuar në llog. e misioneve të mësipërme me arsyetimin për të mos u djegur në fund të vitit.

Likujdimi i vlerës së blerjes së automjeteve është kryer nga përfaqësitë nga llogaria e tyre e çelur sipas transfertave nga llog. 600, 601, 602, 605 dhe jo nga llog 231 për të cilën gjatë vitit 2015 nuk ka çelje.

Memorandumi për vendimmarrje nr. 48/1, dt. 25.02.2015 nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm z. Q.Q. i është drejtuar Ministrit ku i kërkohet miratimi për procedurën që duhet të ndiqet për prokurimin e automjeteve nga MPJ për përfaqësitë në kundërshtim me VKM nr. 28, dt. 14.01.2015, i ndryshuar, nën pika 1.3 “*Përyjashtimisht, lejohen përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, që procedurat për blerje automjetesh ti realizojë vetë, sipas rregullave të tyre të brendshme*”.

Nga MPJ janë marrë të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore për të kryer vetë procedurat e prokurimeve.

- me shkresën nr. 6845, dt. 15.04.2015 drejtuar konsullatës së përgjithshme të Shqipërisë në Bari nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse znj. B.K dërgohet udhëzimi që në zbatim të urdhrin të firmosni kontratën për blerjen e automjeteve me koncesionarin Mercedes Benz në Bari.

Për sa më lartë mbajnë përgjegjësi Sekretari i Përgjithshëm Q.Q. Drejtori i Planifikimit të Buxhetit dhe Financës I.D, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse B.K.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R